




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm në MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 05.02.2024 VI-020-82
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 02 Nr. 463/02-5034 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës komunale të Komunës së Glllogocit – Shërbimit Gjeologjik të Kosovës
I miratuar më datë: 29.01.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.01.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2024, ka miratuar Vendimin 02 Nr. 463/02-5034 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës komunale të Komunës së Glllogocit – Shërbimit Gjeologjikë të Kosovës.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, është bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 7 dhe 10 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 24 dhe 25 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 5, 7 dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Glllogocit, si dhe Kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë Nr. 01-420 dt. 22.01.2024.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Glllogocit me datë 29.01.2024, është miratuar më 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik opštine Glogovac Milaim Hajdari, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, v.d. generalnog sekretara MALS-a,	
Od:	Besim Myrtezani, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS	Dana, 05.02.2024 VI- 020-82
1.Službenik za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština	
2. Službenik za izradu pravne ocene	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac	
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine Glogovac	

Poštovani/a gradonačelnice,

Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 02 br. 463/02-5034 o davanju na dugoročno korišćenje na 99 godina nepokretne opštinske imovine opštine Glogovac - Geološkoj službi Kosova
Usvojena dana, 29.01.2024. godine,
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 30.01.2024. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština Opštine Glogovac je na sednici održanoj 29.01.2024. godine, usvojila Odluku 02 br. 463/02-5034 o davanju na dugoročno korišćenje na 99 godina nepokretne opštinske imovine opštine Glogovac - Geološkoj službi Kosova

MALS konstatuje da je odluka koju je donela Skupština opštine Glogovac zasnovana na članu 11, 12, i 40 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 7 i 10 Zakona br. 06/L-092 o davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, članu 24 i 25 Uredbe (VRK) br. 06/2020 o utvrđivanju postupka davanja na korišćenje i zamenu nepokretnosti opštine, članu 5, 7 i članu 34 Statuta opštine Glogovac, kao i Zahteva Ministarstva privrede br. 01-420 dt. 22.01.2024.godine.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Glogovac dana, 29.01.2024. godine, usvojena je sa 21 glasa za, 0 protiv i 0 uzdržanih.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 463/02-5034 dt. 29.01.2024



HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS GENERAL REQUEST / ZHRJEVA / GOVORNO ZAHTEVANJE		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministristvo Lokalne Samostojice i Administratave Ministry of Local Government Administration		
Data Datum Date:	30.01.2024	
Nënkarta organizative	Nr. i Lambës	Vlera
-VI-	020-82	

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40 Ligjit për Vetqeverisjen lokale nr.03/L-040 gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008, nenit 7 dhe 10 të Ligjit për dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës “Gazeta zyrtare” e Republikës së Kosovës nr.06/L-092, nenit 24 dhe nenit 25 të Rregullorës (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5,7, dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, si kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë nr.01-420 dt.22.01.2024, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

I. Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit, Ministrisë së Ekonomisë - Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, për ndërtimin e “Stacionit Sizmik Sekondar” në zonën kadastrale Kishnarekë, të Komunës së Drenasit.

-Propozimi është për zonën kadastrale në Kishnarekë në pjesën e ngastrës kad. Nr.P-70314033-00872-2 me kulturë kullosë e Klases 6, në sipërfaqe prej $S=100\text{ m}^2$, e cila është në pronësi të Komunës së Drenasit/Glllogocit.

II. Qëllimi për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone është: për Ndërtimin e Stacionit Sekondar Sizmik- të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.

III. Obligohët parashtruesi i kërkeses që në bashkpunim me Drejtorin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Drenasit të siguroi dokumentacionin valid si lejen e ndërtimit dhe kushtet tekniko-urbanistike për lokacionin e destinuar për ndërtim e këtij objekti-Stacionit Sizmik Sekondar në zonën kadastrale në Kishnarekë.

IV. Obligohët gjithashtu edhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas miratimit të këtij vendimi të bënë bartjen administrative për 99 vite të sipërfaqës prej 100 m^2 në emër të shfrytëzuesit – Ministrisë së Ekonomisë - Shërbimit Gjeologjik të Kosovës –Stacionit Sizmik Sekondar, pra të bënë rexhistrimin në RDPP.

V. Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetentë të Komunës së Drenasit.

VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

A r s y e t i m

Duke pasur parasyshë kërkesën nr.01-420 të dt.22.01.2024 të Ministrisë së Ekonomisë- Shërbimit Gjeologjikë të Kosovës për ndërtimin e objektit të Stacionit Sizmik Sekondar, në zonën kadastrale në Kishnarekë në parcelen P-70314033-00872-2.

E cili ju është drejtuar Kryetarit të Komunës së Drenasit për iniciimin e procedurave për të lëshuarë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të sipërfaqen prej 100 m², e cila është pjesë e parcelës 872-2 në zonën kadastrale Kishnarekë.

Drejtorati për Gjeodezi. Kad. dhe Pronë me datë.22.01.2024 ka caktuar ekipin profesional i cili ka dal në vendshiqim dhe ka bërë matjet gjeodezike për lokacionin për ndërtimin e objektit-të Stacionit Sizmik Sekondar, në zonen kadastrale në Kishnarekë në parcelen P-70314033-00872-2.

Pjesë përbërse e këtijë propozim-vendimi janë:

- Kërkesa nr.01-420 dt.22.01.2024 e Ministrisë së Ekonomisë- Shërbimit Gjeologjikë të Kosovës;
- Certifikatat mbi të drejtat e pronës;
- Kopja e planit si dhe
- Skica se ku do bëhet ndërtimi i objektit të Stacionit Sizmik Sekondar, në Zonën Kadastrale Kishnarekë, të Komunës se Drenasit .



Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Glllogocit)
Zyra e Kryetarit



Nr. 01- 463/02-3980, Dt. 22.01.2024

Bazuar në dispozitat e nenit 58 të Ligjit për vetqeverisjen lokale nr.03/L-040 gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008, nenit 7 dhe 10 të Ligjit për dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës “Gazeta zyrtare” e Republikës së Kosovës nr.06/L-092, nenit 24 dhe nenit 25 të Rregullorës (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5,7, dhe nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, si kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë nr.01-420 dt.22.01.2024, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Drenasit të miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

I. Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit, Ministrisë së Ekonomisë - Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, për ndërtimin e ‘Stacionit Sizmik Sekondar’, në zonën kadastrale Kishnarekë, të Komunës së Drenasit.

-Propozimi është për zonën kadastrale në Kishnarekë në pjesën e ngastrës kad. Nr.P-70314033-00872-2 me kulturë kullosë e Klases 6, në sipërfaqe prej $S=100\text{ m}^2$, e cila është në pronësi të Komunës së Drenasit/Glllogocit.

II. Qëllimi për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone është: për Ndërtimin e Stacionit Sekondar Sizmik- të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.

III. Obligohet parashtruesi i kërkesës që në bashkpunim me Drejtorin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Drenasit të siguroi dokumentacionin valid si lejen e ndërtimit dhe kushtet tekniko-urbanistike për lokacionin e destinuar për ndërtim e këtij objekti-Stacionit Sizmik Sekondar në zonën kadastrale në Kishnarekë.

IV. Obligohet gjithashtu edhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas miratimit të këtij vendimi të bënë bartjen administrative për 99 vite të sipërfaqës prej 100 m^2 në emër të shfrytëzuesit – Ministrisë së Ekonomisë - Shërbimit Gjeologjik të Kosovës –Stacionit Sizmik Sekondar, pra të bënë rexhistrimin në RDPP.

V. Me këtë Vendim do të njohtohen organët kompetente të Komunës së Drenasit.

VI. Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPI.-së.



Kryetari i Komunës:

Ramiz Lladrovci
per Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Duke pasur parasyshë kërkesën nr.01-420 të dt.22.01.2024 të Ministrisë së Ekonomisë- Shërbimit Gjeologjikë të Kosovës për ndërtimin e objektit të Stacionit Sizmik Sekondar, në zonën kadastrale në Kishnarekë në parcelen P-70314033-00872-2.

E cili ju është drejtuar Kryetarit të Komunës së Drenasit për iniciimin e procedurave për të lëshuarë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të sipërfaqen prej 100 m², e cila është pjesë e parcelës 872-2 në zonën kadastrale Kishnarekë.

Drejtorati për Gjeodezi. Kad. dhe Pronë me datë.22.01.2024 ka caktuar ekipin profesional i cili ka dal në vendshiqim dhe ka bërë matjet gjeodezike për lokacionin për ndërtimin e objektit-të Stacionit Sizmik Sekondar, në zonen kadastrale në Kishnarekë në parcelen P-70314033-00872-2.

Pjesë përbërse e këtijë propozim-vendimi janë:

- Kërkesa nr.01-420 dt.22.01.2024 e Ministrisë së Ekonomisë- Shërbimit Gjeologjikë të Kosovës;
- Certifikatat mbi të drejtat e pronës;
- Kopja e planit si dhe
- Skica se ku do bëhet ndërtimi i objektit të Stacionit Sizmik Sekondar, në Zonën Kadastrale Kishnarekë, të Komunës se Drenasit .



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Regjion: G. B. Org. J. D. B. Org. Unit: No. Dokument: Org. Shprehje: No. shprehje:	No. Prot. 420 Org. Prot. No. Data: 22.01.24 Data: Data: PRISTINE A NC 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

DATË/A:	22.01.2024
PËR/ZA/TO:	Ramiz Lladrovi. Kryetar, Komuna e Drenasit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
CC:	Luan Morina UD, Drejtor Ekzekutiv, SHGJK, ME Znj. Leonita Shabani-Mullarama, U.D. Sekretare e Përgjithshme, ME
NGA/OD/FROM:	Artane Rizvanolli, Ministre e ME
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për marrjen në shfrytëzim prej një ari (10cm) 10X10m) për ndërtimin e stacionit sizmik sekondar në Kishnarek, Komuna e Drenasit

I nderuar z. Lladrovi,

Për informimin tuaj, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës (SHGJK) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë (ME), sipas Ligji Nr. 06/1 -039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, Nenit 16 Shërbimet Sizmologjike, ka përgjegjësin e menaxhimit të rrjetit sizmologjik si dhe monitorimit të gjitha aktivitetet që lidhen me ngjarjet sizmike në Republikën e Kosovës, dhe më gjerë,

Në funksion të konsolidimit të rrjetit sizmik, deri më tani janë ndërtuar gjithsej 6 (gjashtë) stacione sizmike në komunat si në vijim: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Rahovec. Këto stacione shërbejnë për vendosjen e stabilimenteve përkatëse teknike, të cilat mbledhin informacionin e nevojshëm për analiza me qëllim të përgatitjes së informacionit për publikun për çështjet që lidhen me lëvizjet sizmike /tërmetet.

Sipas rekomandimit të studimit paraprak, ne kemi alokuar një buxhet për vitin 2024 për ndërtimin e stacionit të radhës, ku sipas informacionit të gjeneruar nga analizat teknike profesionale do të duhet të jete në komunën e Drenasit.

Në bazë të rekomandimit të studimit përkatës, koordinatat e dërguara përmes shkresës paraprake të dërguar tek ju me datë 19.12.2023 me numër prot.6565, pas verifikimit nga zyrtarët tuaj komunale këto koordinatat kanë rezultuar si lokacion në pronë private.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 16 të Ligjit Nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, dhe nenin 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në funksion të gjetjes së alternativave tjera në pronën publike të komunës e Drenasit, ekipet tona të nivelit teknik – profesional kanë bërë verifikimet tjera për lokacione të mundshme, dhe si rrjedhojë ka rezultuar që lokacioni në zonën kadastrale Kishnarek, pjesa e parcelës 00872-2, me koordinatat Y:7490241.319, X:4712872.554 dhe Z:700.265 është formacion i njëjtë gjeologjik dhe mund të konsiderohet si lokacion i përshtatshëm për ndërtimin e stacionit të ri sizmik.

Prandaj, përmes kësaj shkrese:

Kërkojmë

Që të zhvillohni të gjitha procedurat përkatëse me qëllim të vënies në dispozicion për shfrytëzim, për një periudhë relativisht të gjatë kohore (99 vite) të një hapësire prej një ari. (100m², 10mX10m) ku nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, përkatësisht Ministria e Ekonomisë, do të ndërtohet një objekt në të cilin do të vendosen pajisjet e stacionit sizmik, të tipit sekondar. Kjo hapësirë, sipas rekomandimit të ekipeve tona profesionale/teknike, do të duhet të sigurohet në fshatin Kishnarek, Komuna e Drenasit, në koordinatat si në vijim:

- Y 7490241.319
- X 4712872.554
- H 700.265

Shënim: Në shtojcën 1- Keni detajet teknike që lidhen me këtë proces si dhe Skicën e propozuar nga ekipet tona profesionale/teknike për ndarjen e parcelës në fshatin Kishnarek.

Duke konsideruar se kjo praktikë është ndjekur edhe në rastet kur kemi marr në dispozicion hapësirat për ndërtimin e stacioneve sizmike në komunat tjera, ju lutem që pa hezitim, këtë kërkesë ta trajtoni me prioritet dhe në një afat sa më të shkurtër të kemi një përgjigjeje pozitive nga ana juaj sa më parë, si parakusht për zhvillimin e procedurave të mëtejme për ndërtimin dhe instalimin e pajisjeve përkatëse gjatë vitit 2024.

Gjithashtu, ju njoftojmë SHGJK është në gatishmëri për të diskutuar për ndonjë çështje që potencialisht mund të kërkon sqarim të mëtejme.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republica Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70314033-00872-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	22/01/24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	22.01.2024 - 09:05
Komuna / Opština / Municipality:	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Kishnarekë / Kishnarekë / Kishnarekë
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70314033-00872-2	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	366190	0002-84		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS


Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
RUDINA-RUDINA				

A.2 LLOJI I SHËRËVETËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parces Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parces Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Supërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësori/Poljoprivredno/Agriculture	Kulllosa/Pashnjaci/pasture	Kulllosë E Klases 6/Pashnjak 6 Klase/6th Class Pasture	366190

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Početnosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseddin individual / Individualna Drazavina / Single possessor	Komuna e Glogocit	600316708	GLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC /		FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI	1/1	0002-84	





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO


QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kishnarekë



Shkalla/Razmera/Scale: 1:7973

Punoi/Obradio/Created: Safet Hoxha

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Belaška/Note:

Data/ Data/Date: 22.01.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:06:45




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLOGOC



Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Sektori për Gjeodezi
Zona Kadastrale Kizharekë
dt.22.01.2024

Skicë e propozuar për ndarje të parcelës




P: 1000

Një pjesë të parcelës nr.00872-2 kemi propozuar për ndarjen e saj e cila parcelë është në pronësi Komuna Glogoc, shfrytëzimi aktual është kullosë e kl.6 me sipërfaqe 366190 ha
Sipërfaqja e propozuar për ndarjen e parcelës është 100m² me dimensione (10*10) në skicë kemi paraqitur me ngjyrë të kuqe.

Shefi i Sektorit të Gjeodezisë



Drejtori për DGJKP



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

DATË/A:	22.01.2024
PËR/ZA/TO:	Ramiz Lladrovi, Kryetar, Komuna e Drenasit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
CC:	Luan Morina U.D. Drejtor Ekzekutiv, SHGJK, ME Znj. Leonita Shabani-Mullarmana, U.D. Sekretare e Përgjithshme, ME
NGA/OD/FROM:	Artane Rizvanolli, Ministre e ME
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për marrjen në shfrytëzim prej një ari (10m x 2, 10X10m) për ndërtimin e stacionit sizmik sekondar në Kishnarek, Komuna e Drenasit

I nderuar z. Lladrovi,

Për informimin tuaj, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës (SHGJK) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë (ME), sipas Ligji Nr. 061 -039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, Nenit 16 Shërbimet Sizmologjike, ka përgjegjësin e menaxhimit të rrjetit sizmologjik si dhe monitorimit të gjitha aktivitetet që lidhen me ngjarjet sizmike në Republikën e Kosovës, dhe më gjerë,

Në funksion të konsolidimit të rrjetit sizmik, deri më tani janë ndërtuar gjithsej 6 (gjashtë) stacione sizmike në komunat si në vijim: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiçan, Mitrovicë dhe Rahovec. Këto stacione shërbejnë për vendosjen e stabilimenteve përkatëse teknike, të cilat mbledhin informacionin e nevojshëm për analiza me qëllim të përgatitjes së informacionit për publikun për çështjet që lidhen me lëvizjet sizmike (tërmetet).

Sipas rekomandimit të studimit paraprak, ne kemi alokuar një buxhet për vitin 2024 për ndërtimin e stacionit të radhës, ku sipas informacionit të gjeneruar nga analizat teknike profesionale do të duhet të jete në komunën e Drenasit.

Ne bazë të rekomandimit të studimit përkatës, koordinatat e dërguara përmes shkresës paraprake të dërguar tek ju me datë 19.12.2023 me numër prot.6565, pas verifikimit nga zyrtarët tuaj komunalë këto koordinatat kanë rezultuar si lokacion në pronë private.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 16 të Ligjit Nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, dhe nenin 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në funksion të gjetjes së alternativave tjera në pronën publike të komunës e Drenasit, ekipet tona të nivelit teknik – profesional kanë bërë verifikimet tjera për lokacione të mundshme, dhe si rrjedhojë ka rezultuar që lokacioni në zonën kadastrale Kishnarek, pjesa e parcelës 00872-2, me koordinatat Y:7490241.319, X:4712872.554 dhe Z:700.265 është formacion i njëjtë gjeologjik dhe mund të konsiderohet si lokacion i përshtatshëm për ndërtimin e stacionit të ri sizmik.

Prandaj, përmes kësaj shkrese:

Kërkojmë

Që të zhvillojë të gjitha procedurat përkatëse me qëllim të vënies në dispozicion për shfrytëzim, për një periudhë relativisht të gjatë kohore (99 vite) të një hapësire prej një ari, (100m2, 10mX10m) ku nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, përkatësisht Ministria e Ekonomisë, do të ndërtohet një objekt në të cilin do të vendosen pajisjet e stacionit sizmik, të tipit sekondar. Kjo hapësirë, sipas rekomandimit të ekipeve tona profesionale/teknike, do të duhet të sigurohet në fshatin Kishnarek, Komuna e Drenasit, në koordinatat si në vijim:

- Y 7490241.319
- X 4712872.554
- H 700.265

Shënim: Në shtojcën 1- Keni detajet teknike që lidhen me këtë proces si dhe Skicën e propozuar nga ekipet tona profesionale/teknike për ndarjen e parcelës në fshatin Kishnarek.

Duke konsideruar se kjo praktikë është ndjekur edhe në rastet kur kemi marrë në dispozicion hapësirat për ndërtimin e stacioneve sizmike në komunat tjera, ju lutem që pa hezitim, këtë kërkesë ta trajtoni me prioritet dhe në një afat sa më të shkurtër të kemi një përgjigjeje pozitive nga ana juaj sa më parë, si parakusht për zhvillimin e procedurave të mëtejme për ndërtimin dhe instalimin e pajisjeve përkatëse gjatë vitit 2024.

Gjithashtu, ju njoftojmë SHGJK është në gatishmëri për të diskutuar për ndonjë çështje që potencialisht mund të kërkon sqarim të mëtejme.

Me respekt!